



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.402/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Swiss Bau” Shpk, me seli në Prizren, magjistrala Prizren – Gjakovë, të cilin e përfaqëson A.Sh. –drejtor i përgjithshëm, ndërsa sipas autorizimit e përfaqëson Visar Ostrozubi avokat nga Prizreni, ndaj debitorit “Teuta Cos” shpk, me seli në Prizren, rr. “Ferizaj” nr.37, të cilën e përfaqëson H.J.-pronare ndërsa sipas autorizimit e përfaqëson avokat Alija Ajro avokat nga Prizreni, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.156/21 dt.20.12.2021, me datën 02.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Teuta Cos shpk, me seli në Prizren, rr. “Ferizaj” nr.37, të cilën e përfaqëson H.J.-pronare, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.156/21 i datës 20.12.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.156/21 dt.20.12.2021, ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Teuta Cos” shpk, me seli në Prizren, rr. “Ferizaj” nr.37, të cilën e përfaqëson H.J.-pronare, ndërsa ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.1224/2021 dt.24.05.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, po ashtu ka vendosur që pala që e humbë procesin gjyqësor përmbartimor të bartë të gjitha shpenzimet e përmbartimit.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe çështjen ta kthejë në shkallë të parë në rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Swiss Bau” Shpk, me seli ne Prizren, magjistrala Prizren – Gjakovë, me datën 24.05.2021 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit “Teuta Cos” shpk, me seli ne Prizren, rr. “Ferizaj” nr.37, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.02/2021 dt.01.03.202. Përmbaruesi Rushit Hoxha nga Prizreni, pas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.1224/2021 dt.24.05.2021, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër te borxhit nga fatura, kreditorit t’i paguaj shumën prej 20,000.00 euro, me kamatëvonesë prej 8% ne vit nga dita e arritjes se afatit te pagesës e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës, te gjitha ne afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit te këtij urdhri.

Kundër urdhrit përmbarimor, debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përmbarimi nuk është e përshtatshme për përmbarim. Përmbaruesi Privat nuk ka dhënë afatin 7 ditor për ta obliguar debitorin ne përmbushje te detyrimit ndaj kreditorit. Bazuar ne nenin 32 par.1 te LPP i referohet detyrimeve reciproke mes tij dhe kreditorit sa i përket detyrimeve reciproke mes tyre, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbarimor ta shfuqizoj.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datën 04.06.2021, me arsyetimin se pretendimet e parashtruara ne prapësim nga debitori nuk kanë asnjë bazë ligjore sepse urdhri përmbarimor është bazuar ne faturën nr.02/2021 dt.01.03.2021 e cila përmban afatin prej 60 ditësh për pagesë dhe ka te gjitha elementet që e njëjta te jetë dokument i besueshëm. Prapësimi ka për qëllim prolongimin e çështjes, andaj propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitori dhe urdhrin përmbarimor ta vërtetoj.

Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.156/2021 dt.20.12.2021, me të cilin e ka refuzuar si i te pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor si dhe ka vendosur për shpenzimet procedurale, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv te vendimit te saj. Ne vazhdim ka arsyetuar se debitori nuk e ka paguar detyrimin ne tërësi ndaj kreditorit dhe se pala kreditore ka bërë propozim për përmbarim për pjesën e papaguar nga debitori. Gjykata konsideron se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë sepse fatura për te cilën kërkohet përmbarimi i përmban te gjitha elementet për tu përmbaruar, shton se nuk ka prova se fatura ne fjalë si dokument i besueshëm është anuluar apo është lënë pa efekt juridik, ndërsa sa i përket pretendimeve te palës debitore se palët kontraktuese kane detyrim reciprok kontraktual nga ku dalin edhe obligimet e palëve ne këtë raport juridik, për gjykatën ne procedurën përmbarimore nuk mund te shqyrtohen pasi nuk hynë ne kompetencën lëndore te kësaj procedure por te njëjtat mund te ngritën ne ndonjë procedurë tjetër siç është ajo kontestimore, Debitori, prapësimit nuk i ka bashkangjitur asnjë provë dhe shkaqet e thirrura ne kundërshtim nuk përbejnë asnjë nga shkaqet

nga neni 71 par.1 te LPP. Vendimin për shpenzimet gjykata e ka vendosur ne kuptim te nenit 13 te LPP dhe nenit 450 te LPK, ashtu qe ka vendosur si ne dispozitiv te vendimit.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe as ne konstatim të gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës nr.02/2021 dt.01.03.2021, të lëshuar nga kreditori, e cila në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, ka cilësinë e dokumentit të besueshëm sepse është e nënshkruar dhe e vulosur nga ana e debitorit ashtu qe konsiderohet se e njëjta është pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori dhe si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj, e kjo, sepse me plotësimin e këtyre elementeve, dokumenti ka fuqinë ekzekutuese nga rezulton edhe fakti se debitori e ka pranuar detyrimin. Prandaj nuk qëndron pretendimi i debitorit se fatura mbi bazën e te cilës është iniciuar propozimi për përmbartim nuk është e përshtatshme për tu përmbartuar.

Dhomat e shkallës së dytë, analizoi edhe pretendimet e debitorit se me kreditorin kanë detyrime reciproke referuar këtu faturës nr.6 dt. 05.05.2021 qe del nga këto detyrime, por vlerëson se ne këtë rast bazë për iniciimin e procedurës përmbartimore është vetëm fatura nr.02/2021 dt.01.03.2021 dhe se për gjykatën fakti se procedura përmbartimore i nënshtrohet parimit te rigorozitetit formal raportet juridike kontraktuale dhe detyrimet reciproke te palëve qe dalin nga këto raporte ne këtë procedurë nuk mund te shqyrtohet sepse kompetencë e kësaj procedure janë vetëm përmbushja formale e elementeve te dokumentit mbi bazën e te cilit është iniciuar procedura përmbartimore.

Me te drejt gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se prapësimi nuk është i bazuar dhe nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP-së, andaj pretendimet e debitorit edhe kjo gjykatë i vlerësoi si te paqëndrueshme dhe te paargumentuara ne prova konkrete ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, dhe si te tilla nuk ndikojnë ne një vendosje ndryshe për çka kjo gjykatë i refuzoi si te pabazuara.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.402/23 me datë 02.04.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha